



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE



RELACIONI PARAPRAK I VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS

Projekt – Zbatimi “Rikonstruksion i Shkollës 9 -vjeçare
"Marigo Posio" Vlorë ”

AUTORITETI KONTRAKTOR
“BASHKIA VLORE”

OPERATORI EKONOMIK
“DERBI-E” Sh.p.k

Vlore Qershor 2025



DERBI-E STUDIO



Tabela e permbajtjes

1	Hyrje	4
1.1	Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-se	5
1.2	Metodika e kryerjes se V.N.M.-se.....	5
2	Kuadri Politik, Ligjor Dhe Administrativ.....	7
2.1	Politika.....	7
2.2	Baza ligjore	7
2.2.1	Përmbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional	7
2.2.2	Kuadri Ligjor Nderkombetar	8
2.2.3	Kuadri Ligjor European.....	9
3	Përshkrimi i projektit “Ndërtim i shkollës profesionale “Bajram Curri””;.....	10
3.1	Pozita gjeografike.....	10
3.2	Permbledhje e projektit dhe konteksti	11
3.2.1	Analiza e territorit dhe gjendjes ekzistuese	11
3.2.2	Objekti i propozuar	13
3.2.3	Bimesia.....	18
3.3	Kushtet e terrenit.....	19
3.3.1	Kushtet klimatike.....	19
3.3.2	Studimi topografik.....	20
4	Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	22
4.1	Ndikimi në Mjedis i ndertimit te objektit.....	22
4.1.1	Shkarkime ne ajer	29
4.1.2	Shkarkime ne ujera	30
4.1.3	Mbetje te ngurta ne toke.....	30
4.1.4	Ndikimet ne biodiversitet	30
4.2	Përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis.....	32
4.2.1	Mbetjet e lengeta.....	32
4.2.2	Prodhimi i mbetjeve	32
4.2.3	Ndikimi i zhurmave	32
4.2.4	Rastet aksidentale	32



4.2.5	Ndikimi mbi shendetin e punetoreve	32
4.3	Matrica e ndikimeve ne mjedis.....	33
4.3.1	Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se ndertimit.....	35
5	Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar; 37	
5.1	Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te indentifikuar (Shkalla).....	37
5.1.1	Shtrirja fizike.....	37
5.1.2	Kohezgjatja e ndikimit.....	37
5.1.3	Kthyesmeria	37
5.1.4	Rendesia	37
5.1.5	Shtrirja e mundshme hapsinore e ndikimeve negative në mjedis.....	37
6	Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis; 39	
6.1	Masat zbutese per eliminimin e ndikimeve ne mjedis qe duhen zbatuar nga subjekti ndertues , i kontraktuar nga Investitori.....	40
6.1.1	Per mbrojtjen e cilesise se ajrit.....	41
6.2	Per mbrojtjen e ujrave siperfaqesore e nentokesore.....	41
6.2.1	Mbetjet e lengeta	41
6.2.2	Per trajtimin e mbetjeve te ngurta.....	41
6.2.3	Mbrojtja nga zjarri, nga aksidentet dhe ruajtja e shendetit te punonjesve .	42
6.2.4	Zhurmat dhe trafiku.....	42
7	Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit	42
7.1	Plani i monitorimit.....	42
7.1.1	Efektet potencialet ndotese te mjedisit dhe masat mbrojtese gjate fazes se ndertimit dhe gjate fazes se operimit.....	43
7.2	Programi i monitorimit.....	43
7.2.1	Aspektet kryesore qe do te jene ne vemendje te monitorimit:.....	43
7.3	Plani i monitorimit gjate ndertimit	44
8	Perfundime	44



1 Hyrje

Shkolla “Marigo Posio” është një godinë ekzistuese katërkatëshe, e ndërtuar rreth viteve 1990, e cila ka pësuar disa rikonstruksione të pjesshme gjatë dekadave të fundit, por pa një ndërhyrje tërësore transformuese. Objekti paraqitet në gjendje të mirë strukturore, por elementët e saj të rifiniturës dhe sistemet teknike janë të amortizuara dhe të papërshtatshme për përdorim afatgjatë në një mjedis arsimor bashkëkohor.

Godina ka një territor relativisht të bollshëm dhe të organizuar mirë nga pikëpamja funksionale, por me nevoja të qarta për përmirësim estetik, funksional dhe teknik. Mungesa e termoizolimit, prania e lagështirës në tarracë, dëmtimet në parketin e palestrës, sistemet elektrike dhe hidraulike të amortizuara, si dhe mungesa e një sistemi funksional ngrohje-ftohje janë ndër problemet më të theksuara.

Aktualisht, shkolla mirëpret rreth 250 nxënës të cikleve fillor dhe të mesëm të ulët. Aksesit në objekt është i favorshëm falë rrugës “Fan Noli”, e cila e lidh drejtpërdrejt shkollën me rrjetin rrugor lokal.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të kontribuoni në modernizimin, rritjen e standardeve funksionale dhe maksimizimin e kapacitetit të nxënësve. Projekti synon përmirësimin e standardeve të procesit të mësimdhënies dhe sigurisë, si dhe optimizimin dhe sigurimin e lëvizshmërisë dhe aksesueshmërisë efikase, duke iu përmbajtur praktika dhe standarde më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Shkolla 9 Vjecare “Marigo Posio”, propozohet një ndërtim i ri në truallin e godinës ekzistuese. Ajo do të përfshijë ciklet e nevojshme për kopsht dhe arsimin nentevjekar

Ky raport paraprak i vleresimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim të përshkruajë, identifikojë dhe vlerësojë efektet e mundshme domethënëse të zbatimit të Projektit të kerkuar për zhvillimin e projektit në teresi me elementet e vet perberes te planifikuar konform standarteve te projektimit.

Vleresimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek: njerezit, flora dhe fauna, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klima, terrenin dhe ndërtimi tij dhe ndërveprimin e këtyre faktoreve me trashëgiminë kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në menjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur, me të drejte dhe që në fillim, më mirë se sa të luftohen efektet e tyre në rrjedhim.

Në studimin Mjedisor për ndërtimin e këtij projekti “Shkolla 9 Vjecare “Marigo Posio”,



jane mbajtur parasysh elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit, te renditur si me poshte:

- *Parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera*
- *Ruajtja e shumellojshmerise biologjike sipas bazes natyrore, biogeografike te vendit*
- *Perdorimi racional i burimeve natyrore dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre*
- *Riaftesimi ekologjik i zonave te demtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukurite natyrore shkaterruese*
- *Ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe permiresimi i cilesise se jetes*

Studimi ka marre parasysh mbrojtjen e mundshme maksimale te biodiversitetit, parandalimin e problemeve te mundshme mjedisore ne te ardhmen. Elementet baze te metodologjise se perdorur e trajtojne zhvillimin e kesaj zone si nje proces te vazhdueshem dhe adaptiv te administrimit te burimeve. Ne kete drejtim, ka rendesi kuptimi i plote i marredhenieve midis vleresimit te sakte te vleres se pasurive natyrore, perdorimit efektiv te tyre dhe ndikimit te ndersjellte midis zhvillimit ekonomik te vendit dhe ruajtjes se mbrojtjes se mjedisit.

1.1 Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-se

Objektivat e V.N.M.-se konsistojne ne analizimin e faktoreve lokale e negative mjedisore, ne dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton ne permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit gjate ndertimit dhe shfrytezimit te veprave te ndertimit.

Qellimi i V.N.M.-se eshte, qe nepermjet vleresimit cilesor e sasior paraprak te parametrave hidrologjike te treguesve gjeologo-inxhinjike, parametrave sizmo-tektonike, morfologjike e gjeomorfologjike te bazuara ne kriteret e standarte shkencore nderkombetare, te tipizohen dhe te perzgjidhen nje sere parametrash dhe vecorish te sistemeve te siperpermendur natyrore, ne sherbim te infrastruktures mjedisore, te infrastruktures urbane si dhe ndertimit dhe shfrytezimit te veprave te ndertimit, etj.

Ky raport ka per qellim te sherbeje:

- *Si instrument per mbrojtjen e mjedisit;*
- *Ne fuqizimin e komunitetit per veprime ne mbrojtje te mjedisit;*
- *Ne kontrollin e perdorimit te qendrueshem te burimeve natyrore;*
- *Ne rritjen e mireqenies nga menaxhimi afatgjate i burimeve ujore;*
- *Ne mbrojtje te pasojave financiare dhe social-ekonomike;*
- *Ne rritje te interesimit per bashkepunim dhe ne gjetjen e zgjidhjeve te reja, etj.*



1.2 Metodika e kryerjes se V.N.M.-se

Studimi vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua;

- *nga rendesia e ndertimit dhe shfrytezimit te veprave te ndertimit, me standartet bashkekohore, nga permbushja e kerkesave vendase dhe te huaja,*
- *nga vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore e humane te zones si dhe vlerave te vecanta te tyre,*
- *ne identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,*
- *marrjen e masave zbutese, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike te investimit,*
- *ne masat orientuese per nje zhvillim te qendrueshem etj.*

Ne kete raport indentifikohen ndikimet lokale e negative ne mjediset humane, si dhe eshte mare parasysh vleresimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme lokale dhe strukturore ne keto faza kyesore:

- *Hartimi i objektivave orientuese te Raportit te V.N.M.-se;*
- *Mbledhja e materialit baze eksistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport (relacioni teknik, topografik, studimi gjeologo-inxhinierik, hidrologjik, elektrik etj), si dhe seleksionimit te tyre per perdorim.*
- *Verifikimi ne terren i te dhenave ekzstuese dhe mbledhja e te dhenave biofizike dhe humane:*
- *Hartimi i V.N.M.-se dhe dorezimi tek porositesit si dhe ne subjektet vendimarese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror*

Shprehja e marredhenieve te mesiperme ne terma fizike e mjedisore, si dhe ne terma ekonomike, ndihmon ne planifikimin, formulimin e politikave, zbatimin dhe kryerjen e vleresimit te drejte te ndikimit ne mjedis te objektivave te planifikuara per ndertimin ne zonen ne studim.

Konkretisht studimi i VNM-se per projektin ne fjale ka marre parasysh:

- *Ruajtjen maksimale te mundshme te mjedisit, e cila realizohet nepermjet:*
- *Sugjerimit te perzgjedhjes se alternativave me me pak ndikime negative ne mjedis,*
- *Perdorimit te burimeve energjitike me efekt minimal ne mjedis.*



2 Kuadri Politik, Ligjor Dhe Administrativ

2.1 Politika

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit Qeveria ka filluar zhvillimin e nje kuadri ligjor për të ndryshuar degradimin mjedisor, i cili ka ardhur si rezultat i industrializimeve të mëparshme dhe ka anashkuar mbrojtjen e mjedisit pothuajse plotësisht. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e legjislacionit, i cili kërkon “të mirëmbaje një mjedis të përshtatshëm, të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”. Legjislacioni kërkon gjithashtu që treguesit urban duhet të shfrytëzohen racionalisht në përputhje me principe të bazuara.

2.2 Baza ligjore

2.2.1 Përmbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional

Ndërgjegjësimi në Shqipëri është i një niveli të ulët, kjo si rrjedhojë e një legjislacioni mjedisor relativisht të ri që është në zhvillim dhe po plotësohet më tej sidomos me rregullore dhe standarte. Aplikimet për V.N.M. kanë si detyrim paketën ligjore të mëposhteme.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket përmendim:

- *Udhëzues Metodik i Ministrise se Mjedisit, Tirane, “Per Pergatitjen e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”*
- *Urdherin e Ministrit Nr. 137, date 17.08.2004. “Per Dokumentacionin e Domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”.*
- *Ligj Nr. 9385 date 4.5.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”*
- *Ligji me Nr. 9587, dt 20.07.2006 “Per Mbrojtjen e Biodiversitetit i Ndryshuar”*
- *Udhëzimin me Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimii e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”.*
- *Ligji me Nr. 10006, dt 23.10.2008 “Per mbrojtjen e Faunes se Eger”*
- *Ligji me Nr.10431, Datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.*
- *Ligji me Nr.10440, Datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.*
- *Ligji me Nr. 10448, Datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”.*



- *Ligj me Nr.10463, Datë 22.09.2011 "Për Menaxhanimin e Integruar te Mbetjeve"*
 - *Ligji me Nr. 111/2012, date 03.12.2012 "Për Menaxhimin E Integruar Të Burimeve Ujore".*
 - *Ligji me Nr. 60/2014 për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, Datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të Ndryshuar.*
 - *Vendim Nr. 13, datë 04.01.2014 për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së V.N.M.*
 - *V.K.M. me Nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimarrje mjedisore".*
 - *V.K.M. Nr. 419, me date 25.06.2014 "Per Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisit të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja*
 - *V.K. M. me Nr. 686, date 29.07.2015 "Per percaktimin e rregullave, pergjegjese e te afateve per zhvillimin e procedures ne vleresimin e ndikimit ne mjedis (V.N.M) dhe procedures se transferimit te vendimit te deklarates mjedisore".*

Raporti i Vleresimit Ndikimit ne Mjedis perfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne mjedisin fizik dhe special. Ky proces zhvillohet brenda atij të planifikimit dhe zbatimit të projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listen e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Raporti realizon bashkëpunimin midis pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe biznesit, duke i paraprirë zhvillimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm. Në vijim janë përshkruar vecoritë kryesore të projektit, të cilat, së bashku me investigimet në vendin e ndërtimit të parashikuar për ushtrim të aktivitetit, kanë shërbyer për identifikimin e ndikimeve të mundëshme në mjedis gjatë ndërtimit të rrugës, objekt i këtij vlerësimi.

2.2.2 Kuadri Ligjor Nderkombetar

Shqipëria është një vënd i cili është tashmë nënshkrues i shumë konvetave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky raport duhet të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe më poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit.

- *Protokolli i Kievit: Për vlerësimin strategjik mjedisor. Ratifikuar në vitin 2005*
- *Protokolli i Kartagjenes: Per biosigurine. Bere pale ne vitin 2005*
- *Konventa e Stockholmit: Mbi ndotësit organike të qëndrueshem. Ligji nr. 9263, datë 29.07.2004*



- *Protokoll i Kartagjenes: Për sigurinë biologjike. Ratifikuar në vitin 2004.*
- *Ligji nr. 9279, datë 23.09.2004*
- *Konventa e Washingtonit: Për trejetinë ndërkombetare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Ligji nr. 9021, datë 06.03.2003*

2.2.3 Kuadri Ligjor Europian

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqsasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore:

- *Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.*
- *Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.*
- *Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.*
- *Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".*
- *Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.*
- *Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.*
- *Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.*
- *Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.*
- *Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.*
- *Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.*
- *Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujerave të embla*
- *Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.*
- *Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.*

Referimet në nivel komunitar në fushën e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të përzgjidhen ato më kryesoret.

Disa nga parimet themelore, parimet bazë, që sugjerojnë linjat e veprimit dhe objektivat që përmbajnë programet komunitare, po i pershkruajme më poshtë.



3 Përshkrimi i projektit “Rikonstruksion i shkollës “Marigo Posio””;

3.1 Pozita gjeografike

Shkolla 9 Vjecare Marigo Posio” ndodhet në qytetin e Vlores prane Bashkise Vlore,.


Pozita e saj gjeografike është në koordinatat: KRGJSH

X=456748 Y=4480877

Rruga “Mustafa Bello” Vlore,Shqiperi.

Shkolla ndodhet në rrugën “Mustafa Bello”, në afërsi të Bulevardit “Marigo Posio”, në rajonin nr. 2 të qytetit të Vlorës. Kjo zonë urbane përbëhet nga ndërtesa publike, banesa kolektive dhe rrugë me densitet të lartë qarkullimi. Vendndodhja e objektit paraqet rëndësi strategjike për komunitetin, pasi ndodhet në një pikë të aksesueshme nga një numër i madh banorësh dhe përmbush nevojat për arsim fillor dhe të mesëm të ulët në këtë pjesë të qytetit.

Kjo shkollë ofron programe mesimore per shkollat 9 vjecare si dhe per parashkolloret.



Vendodhja e shkollës 9 Vjecare "Marigo Posio"

3.2 Permbledhje e projektit dhe konteksti

3.2.1 Analiza e territorit dhe gjendjes ekzistuese

Shkolla "Marigo Posio" është një godinë ekzistuese katërkatëshe, e ndërtuar rreth viteve 1990, e cila ka pësuar disa rikonstrukcione të pjesshme gjatë dekadave të fundit, por pa një ndërhyrje tërësore transformuese. Objekti paraqitet në gjendje të mirë strukturore, por elementët e saj të rifiniturës dhe sistemet teknike janë të amortizuara dhe të papërshtatshme për përdorim afatgjatë në një mjedis arsimor bashkëkohor.

Godina ka një territor relativisht të bollshëm dhe të organizuar mirë nga pikëpamja funksionale, por me nevoja të qarta për përmirësim estetik, funksional dhe teknik. Mungesa e termoizolimit, prania e lagështirës në tarracë, dëmtimet në parketin e palestrës, sistemet elektrike dhe hidraulike të amortizuara, si dhe mungesa e një sistemi funksional ngrohje-ftohje janë ndër problemet më të theksuara.

Aktualisht, shkolla mirëpret rreth 250 nxënës të cikleve fillor dhe të mesëm të ulët. Aksesit në objekt është i favorshëm falë rrugës "Fan Noli", e cila e lidh drejtpërdrejt shkollën me rrjetin rrugor lokal.



DERBI-E sh.p.k

Konsulencë - Projektim - Supervizion

Mob/Cel: +355672057534

Email: derbie.studio@gmail.com

Web: www.derbi-e.com

Rruga e Dibrës | Pranë Komisarariatit Nr 4 | Pallati Andi Konstruksion | Sh 1, H 3 | Tiranë, Albania




Figura 2: Pamje e shkolles « 4 heronjte »

- Sipërfaqja totale e territorit të objektit: 5480 m²;
- Sipërfaqja ndërtimit e godinës kati parë: 650 m²
- Sipërfaqja ndërtimit e godinës kati dytë: 650 m²
- Sipërfaqja ndërtimit e godinës kati tretë: 650 m²

Rikonstruksioni i shkolles sipas standarteve të projektimit të objekteve arsimore të përcaktuar nga MASH dhe të gjithë normativave teknike bashkëkohore.

Objekti i ri është konceptuar të riparohet sipas standardeve të projektimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në përputhje me të gjitha rregulloret teknike të ndërtimit. Ndërhyrja synon të krijojë një mjedis funksional dhe të aksesueshëm që plotëson kërkesat për kapacitetin e nxënësve.



Figura 3: Plan rilevimi topografik



Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Vlorës, parcela i përket Njesisë Strukturore VL.UB. 15.614, e kategorizuar si një zonë me përdorim të përzier dhe densitet mesatar. Zona lejon ndërtime deri në 4 kate, me një lartësi maksimale prej 14.5 metrash. Indeksi i shfrytëzimit (K1) është 1.2, ndërsa koeficienti i shfrytëzimit të tokës (KSHT) është 50%.



Figura 4: Parametrat e zhvillimit Njësia Stukturore VL.UB. 15.614

Te dhenat e PPV:

Njësia Strukturore: Vlorë
VL.UB 15.614
Bashkia
Njësia VL.UB 15.614
Sistemi UB_Urban
Kategori 1 AS.Ärsim
Lartësia në Kate 4
Lartësia në Metra 14.5
PDV JO
Intesitet K1=1.2
KSHT K1=50%

3.2.2 Objekti i propozuar

Projekti synon një rikonstruksion të plotë të ndërtesës ekzistuese, duke ruajtur gjurmën



urbanistike dhe përmasat aktuale të saj, si dhe duke respektuar kufijtë e parcelës dhe orientimin e terrenit. Ndërhyrja synon jo vetëm të përmirësojë aspektet teknike dhe estetike të objektit, por edhe të rrisë ndjeshëm funksionalitetin dhe komoditetin për përdoruesit. Godina ekzistuese është konceptuar me një holl qendror dhe tre korridore që shpërndahen në drejtime të ndryshme, duke mundësuar një organizim të qartë dhe rrjedhshmëri të mirë të qarkullimit.

Në bashkëngjitje me ndërtesën kryesore ndodhet palestra ekzistuese, e cila do të ruhet si pjesë integrale e kompleksit shkollor dhe do t'i nënshtrohet ndërhyrjeve të posaçme për përmirësimin e kushteve të saj funksionale dhe teknike. Palestra do të përshtatet me ambientet teknike si kaldaja, rezervuarët e ujit dhe stacioni i pompave, duke e bërë atë një nyje funksionale që i shërben gjithë shkollës.




Figura 6: Planvendosja e objektit

Ndërhyrjet e planifikuara përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh restauruese dhe përmirësuese, që synojnë të kthejnë shkollën në një ambient bashkëkohor, funksional dhe të sigurt për mësimdhënie. Më konkretisht:



- Do të realizohet rifinitura e plotë e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë suvatimin, lyerjen, zëvendësimin e dyshemeve dhe ndriçimin;
- Fasadat do të termoizolohen dhe do të pajisen me shtresa të reja për mbrojtje nga kushtet atmosferike;
- Tarracat do të pajisen me shtresa të reja hidroizoluese dhe termoizoluese për të eliminuar problemet e lagështirës;
- Do të bëhet një rinovim total i rrjeteve elektrike dhe hidrosanitare;
- Do të instalohet një sistem modern ngrohje-ftohje që rrit ndjeshëm komoditetin termik të ndërtesës;
- Pranë palestrës do të ndërtohet një njësi e veçantë teknike për strehimin e impianteve;
- Shkolla do të pajiset me shkallë emergjente të jashtme për të përmbushur kërkesat e sigurisë dhe evakuimit.

Këto masa janë të nevojshme për të garantuar një ambient mësimor që plotëson kushtet e përdorimit afatgjatë dhe efikas të godinës shkollore.




Figura 7: Plani i sistemimeve te objektit

**Treguesit e zhvillimit:**

Treguesit urbane te godines se shkolles 9-vjecare jane:

Numri i kateve të ndërtësës	4
Sipërfaqe kati përdhe	953 m2/
Kati i pare	622 m2/
Kati i dytë	622 m2/
Kati i tretë	622 m2/
Sipërfaqe e përgjithshme e kateve	2821 m2/
Sipërfaqe e zhvillimit	5480 m2/
Sipërfaqe e sistemeve të jashtme	4527 m2/
Lartësia e objektit	13.1 m

Programi hapësinor

Sipërfaqet neto te hapësirave te propozuara sipas programit jane:

NDËRTIMI I SHKOLLËS 9 -VJEÇARE "MARIGO POSIO"	Numer nxenesish	408
	Numer	Sipërfaqe total m2
Dhoma te pergjithshme mesimi	17	660
Dhoma per mesim te integruar	1	41
Dhoma burimore mesimi	2	85
Laborator (fizike, kimi, biologji, informatike)	6	338
Biblioteke	1	68
Arkiva shkolles	1	15
Salle edukimi fizik dhe dhoma zhveshje	1	246
Drejtori	1	30
Sekretari	1	23
Nendrejtori	1	29
Mjedis per salle mesuesish	1	74
Salle/dhomeper aktivitete	1	74
Dhome psikologu/punonjes social	1	23
Dhome infermieri	1	27
Depo magazinim	1	16
Numri I bokseve WC per nxenes	24	92
Numri I bokseve WC per PAK	4	12
Numri I bokseve WC stafi	4	8
Ambjente teknike	1	58
Holl-Korridor	1	580



DERBI-E sh.p.k
Konsulencë - Projektim - Supervizion

Mob/Cel: +355672057534
Email: derbie.studio@gmail.com
Web: www.derbi-e.com

Rruga e Dibrës | Pranë Komisarariatit Nr 4 | Pallati Andi Konstruksion | Sh 1, H 3 | Tiranë, Albania

Sip. Totale		2499
-------------	--	------



Zgjidhjet funksionale

Zgjidhja funksionale e objektit është hartuar për të ofruar një mjedis të qartë, të aksesueshëm dhe të organizuar në funksion të kërkesave të arsimit bashkëkohor. Tipologjia e ndërtesës me hollin qendror dhe korridore anësore në tre drejtime krijon një sistem qarkullimi të qartë dhe të natyrshëm, duke lehtësuar orientimin dhe lëvizjen e përdoruesve në të gjitha drejtimet. Ndërtesa është e përbërë nga katër kate mbi tokë, ku çdo nivel është konceptuar për të përmbushur funksione të caktuara:




Figura 8: Planimetria e Katit perdhe

Kati përdhe (kuota ±0.00) Përfshin 6 ambiente funksionale: hyrjen kryesore, sallën shumëfunksionale, bibliotekën, infermierinë, dhomën e psikologut dhe punonjësit social, ambientet ndihmëse për pastrim dhe mirëmbajtje. Palestra me dhomat e zhveshjes është pjesë integrale e këtij niveli dhe do të pajiset me akses të veçantë, duke ofruar mundësi përdorimi edhe jashtë orarit mësimor. Një sallë shumëfunksionale në këtë nivel shërben për mbledhje, aktivitete kulturore dhe evente shkollore. Po në këtë kat është vendosur edhe palestra ekzistuese, e cila do të rikualifikohet



dhe do të ketë hyrje të pavarur, duke siguruar përdorim të pavarur edhe jashtë orarit mësimor. Ajo është pajisur me dhoma zhveshjeje dhe impiante të reja teknike për ngrohje dhe ventilim, duke u kthyer në një pikë kyçe për edukimin fizik të nxënësve.

Oborri i jashtëm, i cili komunikon natyrshëm me këtë nivel, është konceptuar si një hapësirë rekreative e hapur, me zona për pushim dhe aktivitete të lehta në natyrë, duke kontribuar në zhvillimin fizik dhe social të nxënësve.




Figura 9: Planimetria e Katit të parë

Kati i parë (kuota +3.15) Përbëhet nga 2 klasa mësimore, 3 laboratorë të specializuar (biologji, kimi, informatikë) dhe ambientet administrative: zyra e drejtorit, sekretaria dhe salla e mësuesve. Në të njëjtin kat ndodhen edhe ambientet administrative, si zyra e drejtorit, sekretaria dhe salla e mësuesve, të pozicionuara në mënyrë që të kenë kontroll funksional mbi hyrjen dhe shpërndarjen në të gjitha hapësirat e shkollës.



DERBI-E sh.p.k

Konsulencë - Projektim - Supervizion

Mob/Cel: +355672057534

Email: derbie.studio@gmail.com

Web: www.derbi-e.com

Rruga e Dibrës | Pranë Komisarariatit Nr 4 | Pallati Andi Konstruksion | Sh 1, H 3 | Tiranë, Albania




Figura 10: Planimetria e Katit te dyte

Kati i dytë (kuota +6.30) Përfshin 5 klasa mësimore dhe 3 laboratorë të tjera për lëndë të ndryshme, me ndriçim natyral dhe qarkullim të lirë nëpërmjet korridoreve të hapura. Nyjet sanitare janë të shpërndara në të dy anët e kateve për të garantuar akses dhe funksionalitet për të gjithë përdoruesit.




Figura 11: Planimetria e Katit te trete

Kati i tretë (kuota +9.45) Përmban 10 klasa mësimore të shpërndara simetrisht përgjatë strukturës ekzistuese. Ambientet kanë ndriçim të bollshëm dhe përfitojnë nga pamja e lirë drejt ambientit të jashtëm. Qasja në këtë nivel garantohet nga shkallët dhe ashensori, në përputhje me normat e aksesueshmërisë.

Të gjitha nivelet janë të aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuara nëpërmjet ashensorit dhe rampave, dhe janë të pajisura me dalje emergjente që përmbushin kërkesat e sigurisë në raste evakuimi. Qarkullimi i brendshëm realizohet në mënyrë të natyrshme falë korridoreve të gjerë dhe strukturës simetrike, ndërkohë që sinjalistika e brendshme do të orientojë përdoruesit në mënyrë intuitive.



Struktura dhe materialiteti

Ndërtesa ekzistuese është ndërtuar me një strukturë tradicionale me mure mbajtëse prej tulle të plotë, të cilat i kanë dhënë objektit qëndrueshmëri afatgjatë dhe rezistencë ndaj kushteve të motit dhe ngarkesave strukturore. Kjo strukturë do të ruhet në rikonstruksionin e propozuar, duke u përforcuar aty ku është e nevojshme, në përputhje me normat aktuale të sigurisë dhe standardet teknike të ndërtimit.

Sistemi konstruktiv parashikon ruajtjen e volumit ekzistues dhe integrimin e elementeve të rinj si shkallët e emergjencës dhe ambientet teknike pranë palestrës. Intervenimet strukturore do të fokusohen në ruajtjen e integritetit statik të objektit, përmirësimin e sistemit të izolimit termik dhe hidroizolimit, si dhe në zbatimin e masave për rritjen e rezistencës ndaj kushteve klimaterike dhe përdorimit të përditshëm.



Figura 12: Pamje 3D

Muret e jashtëm do të termoizolohen me panele polistireni me densitet të lartë, të vendosura mbi sipërfaqet ekzistuese. Në fasadë do të aplikohen veshje dekorative me rezistencë të lartë ndaj lagështirës dhe ndikimeve atmosferike, ndërsa elementet e dritareve dhe dverve të jashtme do të zëvendësohen me profile alumini dhe dopio xham termoizolues për të garantuar ndriçim të mirë natyral, ventilim dhe izolim akustik e termik.

Fasada e godinës do të transformohet estetikisht përmes përdorimit të një game ngjyrash të ngrohta dhe të gëzueshme, duke krijuar një identitet vizual më tërheqës dhe të përshtatshëm për një institucion arsimor. Ky përmirësim do të ketë ndikim pozitiv në atmosferën edukative, duke e kthyer ndërtesën në një mjedis më mikpritës dhe stimulues për nxënësit dhe mësuesit.

Dyshemetë në ambientet mësimore do të realizohen me pllaka gres-porcelani të cilësisë së lartë, me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe të lehta për mirëmbajtje. Në ambientet ndihmëse dhe sanitare



DERBI-E sh.p.k

Konsulencë - Projektim - Supervizion

Mob/Cel: +355672057534

Email: derbie.studio@gmail.com

Web: www.derbi-e.com

Rruga e Dibrës | Pranë Komisarariatit Nr 4 | Pallati Andi Konstruksion | Sh 1, H 3 | Tiranë, Albania

do të përdoren pllaka antirrëshqitëse, ndërsa palestra do të pajiset me një dysHEME speciale sportive me sipërfaqe amortizuese.



Figura 13: Pamje 3D

Shkallët ekzistuese do të rinovohen me bazamakë mermeri dhe shirita antirrëshqitës për siguri të shtuar. Do të aplikohet gjithashtu sinjalistikë e dallueshme vizuale për ndihmë në orientim, veçanërisht për personat me vështirësi në të parë.

Dyert e brendshme do të jenë të uniformuara dhe të përzgjedhura sipas funksioneve të ambienteve përkatëse, me korniza druri ose metalike. Dyert e jashtme do të jenë të blinduara dhe të trajtuara me materiale rezistente ndaj lagështirës dhe ndryshimeve klimatike.



DERBI-E sh.p.k

Konsulencë - Projektim - Supervizion

Mob/Cel: +355672057534

Email: derbie.studio@gmail.com

Web: www.derbi-e.com

Rruga e Dibrës | Pranë Komisarariatit Nr 4 | Pallati Andi Konstruksion | Sh 1, H 3 | Tiranë, Albania



Figura 14: Pamje 3D

Tarracat do të pajisen me sisteme të reja hidroizoluese dhe termoizoluese me performancë të lartë, të përbëra nga membrana bituminoze ose PVC me shumë shtresa. Do të sigurohet gjithashtu një sistem kullimi i optimizuar për përballimin e reshjeve intensive, me pika shkarkimi të pozicionuara strategjikisht përgjatë perimetrit të objektit.



Figura 14: Pamje 3D



Sistemimi i jashtëm përfshin trotuare të shtruara me pllaka betoni për përdorim të jashtëm, shtigje qarkullimi për këmbësorët dhe vende për ulje. Sipërfaqet e gjelbëruara do të rikonceptohen me pemë dekorative dhe elementë peizazhistikë, duke krijuar një mjedis të gjallë dhe relaksues për nxënësit. Rrethimi i territorit do të realizohet me rrjetë metalike të galvanizuar dhe pjesë murature të ulëta, për të garantuar siguri pa krijuar ndarje vizuale të mbyllura. E gjithë ndërhyrja në materialitet dhe strukturë ka për qëllim të garantojë një jetëgjatësi më të madhe të objektit, një funksionalitet më të lartë të hapësirave dhe një përvojë më cilësore për të gjithë përdoruesit e mjediseve shkollore.

Figura 14: Pamje 3D

3.2.3 Bimesia

♣ Pemë dekorative me hije (ideal për oborre e pushimore)

- **Lisi i bardhë (*Quercus pubescens* / *Quercus ilex*)**
 - o Jetëgjatë, e qëndrueshme, jep hije të dendur.
 - o Rritje e ngadaltë, por shumë e qëndrueshme në kohë.
- **Platan (*Platanus orientalis*)**
 - o Rritet shpejt, jep shumë hije.
 - o I përshtatshëm për ambiente të hapura dhe zona pushimi.
 - o Kërkon pak mirëmbajtje.
- **Frashëri (*Fraxinus excelsior*)**
 - o Rritje e qëndrueshme dhe formon një kurorë të bukur.
 - o E mirë për freski dhe oksigjenim.
- **Bagremi i bardhë (*Robinia pseudoacacia*)**
 - o Rritje e shpejtë, përmirëson tokën me azot.
 - o Të zgjidhen varietete pa gjemba për shkolla.



1-Pisha



2-Bredh





3-Lisi

4-Ulliri

3.3 Kushtet e terrenit

3.3.1 Kushtet klimatike

Vlora, është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë, ka klimë mesdhetare tipike.

✓ Stinët

Verë e nxehtë dhe e thatë

Temperaturat mesatare në korrik–gusht: 30–33°C, me maksimumet që mund të arrijnë edhe 36–38°C.

Shumë pak reshje, shpesh periudha të gjata pa shi.

Lagështia relative mund të jetë e lartë, duke shtuar ndjesinë e nxehtësisë.

Dimër i butë dhe me reshje

Temperaturat mesatare në janar–shkurt: 8–12°C, rrallë bie poshtë 5°C.

Reshjet kryesisht në formë shiu; dëbora është shumë e rrallë.

Stuhitë me erë dhe reshje intensive janë të zakonshme.

☁ Reshjet

Reshjet vjetore: 800–1,200 mm

Pjesa më e madhe bie gjatë vjeshtës dhe dimrit.

Periudha më e thatë: qershor–shtator

✶ Era

Prania e erërave bregdetare, që ndihmojnë në freskimin gjatë verës.

Në dimër ndonjëherë fryjnë erëra të forta jugore (si juglindja "Jugo").

☁ Lagështia dhe Deti

Lagështia relative: shpesh 50–70%

Temperatura e detit në verë: 25–27°C, e favorshme për plazh dhe turizëm.

3.3.1.1 Rrezatimi diellor dhe kohëzgjatja e orëve me diell

Qyteti i **Vlorës** ka një nga nivelet më të larta të **rrezatimit diellor** dhe **kohëzgjatjes së diellit** në Shqipëri, për shkak të klimës së tij mesdhetare dhe pozicionit gjeografik bregdetar në jugperëndim të vendit.

*** Rrezatimi Diellor në Vlorë**Mesatarisht 1,500–1,700 kWh/m² në vit

(ky është një tregues i lartë në nivel evropian)

Piku i rrezatimit: Qershor – Korrik

Minimumi: Dhjetor – Janar

Dielli ndikon fuqishëm në:

Efikasitetin e paneleve diellore

Nevojën për mbrojtje nga mbinxehja në ndërtesa

Planifikimin e peizazhit (pemët, hijet etj.)

3.3.1.2 Regjimi termik

Regjimi termik i Vlorës i referohet ecurisë së temperaturave mesatare mujore dhe ekstreme gjatë vitit. Si një qytet bregdetar me klimë mesdhetare të ngrohtë (**Köppen Csa**), Vlorë ka një **regjim termik të butë në dimër dhe të nxehtë në verë**, me luhatje të moderuara për shkak të ndikimit të detit.

🌡 Temperaturat mesatare mujore (°C)

Muaji	Mesatarja ditore	Maksimumi mesatar	Minimumi mesatar
Janar	8 – 9 °C	12 °C	5 °C
Mars	11 – 13 °C	17 °C	7 °C
Maj	18 – 20 °C	24 °C	13 °C
Qershor	23 °C	29 °C	18 °C
Korrik	26 – 27 °C	33 – 35 °C	21 °C
Gusht	26 – 28 °C	34 – 36 °C	22 °C
Shtator	23 – 24 °C	30 °C	19 °C
Nëntor	14 – 15 °C	19 °C	10 °C
Dhjetor	9 – 10 °C	13 °C	6 °C

📊 Ekstremet absolute:

- Minimumi absolut: rreth **-5 °C** (shumë rrallë, në netët më të ftohta të dimrit)
- Maksimumi absolut: deri **39–40 °C** (gjatë valëve të të nxehtit në verë)

📈 Karakteristikat e regjimit termik

- **Amplitude termike vjetore** (diferenca mes temperaturave mesatare të muajit më të nxehtë dhe më të ftohtë): rreth **18–20 °C**.
- **Freski bregdetar** gjatë verës, falë ndikimit të erërave nga deti.
- **Dimra të butë**: shumë të rralla janë netët me ngrica.
- **Verë e gjatë dhe e nxehtë**, që zgjat nga fundi i majit deri në shtator.



3.3.2 Studimi topografik

Puna gjeodezike dhe topografike për projektin e objektit të ndërtimit u bazua në kërkesat teknike të përgjithshme, të kërkesave specifike të parashtruara nga termat e references të renditura në kontratën e investitorit me firmën projektuese, si dhe mbi bazën e përvojës së përfutur në punimet e mëparshme të kësaj natyre.

Njohja fillestare me detyrën topografike motivoje grupin e punës në përgatitjen e materialeve gjeodezike e cila fillon me sigurimin e hartave dhe të koordinatave të pikave mbështetëse gjeodezike për zonën ku shtrihen linjat e cila shërbeu për përcaktimin e saktë të metodikës dhe organizimit të punës dhe për mënyrën e ndërtimit të rrjetit gjeodezik mbështetës. Me pas në terren se bashku me projektuesit, grupi topografik mori udhëzimet për gjurmën e objektit përmirësimi i parametrave të planimetrisë duke pasur parasysh funksionin e saj, si dhe azhurnimi i tyre si nga ana funksionale dhe pershtatja pozicionale.

Grupet në terren përbehen nga një Inxhinier ekspert Topograf, një teknik i mesëm topograf me eksperiencë në procesin e rievimit dhe 2 punëtorë. Pas grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm teknik dhe ligjor grupet e punës në terren do të fillojnë menjëherë punën duke bërë rikonzhionin e objektit. Pas rikonzhionit të zonës filloi materializimi i pikave mbështetëse gjeodezike i cili do të shërbejë për rievimin dhe azhurnimin e gjithë zonës. Metoda për ndërtimin e këtij rrjeti gjeodezik do të bazohet mbi teknologjinë e fundit të shkencës dhe të elektronikës në fushën e gjeodezisë. Për këtë proces do të përdoret GPS LEICA 1200 me një precizion tepër të lartë në matje.

- *Ne distance:* $0.001\text{ m} + 1\text{ppm}$
- *Matje vertikale:* $0.01\text{ m} + 2\text{ ppm}$

Një precizion i tillë do na garantojë arritjen e një saktësie brenda normave të kërkuara. Për rievimin dhe azhurnimin e zonës çdo grup është i pajisur me instrument të një precizioni të lartë Total Station (Trimble M3):

- *Ne distance:* $\pm 3\text{mm} + 3\text{ppm}$
- *Ne kënd:* $0.01\text{ mgon} = 0.1\text{ cc}(1'')$

Përdorimi i instrumentave në fjalë bën të mundur kalimin e informacionit të marrë në terren direkt në kompjuter dhe krijimin pa vështirësi dhe tepër të sakte të hartave treguese. Shpeshtimi i rrjetit gjeodezik për kryerjen e rievimit topografik të brezit të rrugës u krye me metodën e poligonometrisë me dy rënde.

Rendi i parë përbëhet nga poligonometria kryesore, që siguron mbështetjen dhe lidhjen



